



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:291691

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06595414

Kom.Dh.Shk.II.602/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova në çështjen juridike përmbare të kreditorit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës-Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, me adresë ish pallati i mediave “Rilindja”, kati 15, zyre nr.1503 në Prishtinë, kundër debitorit “ALL STONE” Sh.P.K., me NUI 810845068, në fshatin Pasomë në Vushtrri, me pronar M.K., të cilin me autorizim e përfaqëson Fisnik Sogojeva avokat me seli të zyrës në Rr.“Rexhep Luci”, Hyrja 20, Kati III-të, nr.11 në Prishtinë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.425/23 i dt.27.12.2023, me datën 13.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “ALL STONE” Sh.P.K me seli ne në fshatin Pasomë në Vushtrri me NUI 810845068, ndërsa Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr. 425/23 i dt.27.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë - Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit P. nr.08/2023 i dt.15.02.2023, të Përmbaremit Privat, me te cilin ka lejuar urdhrin për përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm aktvendimit te Kreditorit nr. Nr.20-INS-P-3-ID-34, të datës 15.12.2020 me te cilin debitori duhet paguaj kreditorit ne emër te gjobës shumën 1,000.00 €, deri në pagesën përfundimtare, me bllokimin e xhirollogarive që i posedon debitori dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, me sekuestrimin e letrave me vlerë, me sekuestrimin, vlerësimin, me shënimin e përmbaremit në librin publik të paluajtshmërive, dërgimin, të besuarit për ruajtje, me shitje, me qëllim të dorëzimit të sendeve.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, shkelje esenciale të Ligjit LPP me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, anuloj aktvendimin e atakuar dhe lenden të kthejë në rishqyrtim në Dhomat e shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm- vendimit Nr.20-INS-P-3-ID-34, të datës 15.12.2020, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor nr.08/2023 i dt.15.02.2023 ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të gjobës t'i paguaj shumën prej 1,000.00 €,

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e përmbartimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr. 08/2023 i dt.15.02.2023, të Përmbartuesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së përmbartimi është lejuar në baze të dokumentit të besueshëm, vendimit nr. Nr.20-INS-P-3-ID-34, të datës 15.12.2020. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës së parë ka vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, dokumenti përmbartues e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat sit e tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 22 të njëjtë ligj.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe sipas kësaj gjykate aktvendimi i atakuar nuk është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtuan pretendimet ankimore të debitorit, edhe sa i përket shkeljeve esenciale që ndërliken me mungesën e përshtatshmërisë së aktit administrativ në këtë procedurë përmbarimore. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se dokumenti përmbarimor rrjedh nga akti administrativ i nxjerr nga kreditori në procedurë të brendshme, i cili në aspektin formal përmban të gjitha kushtet e parapara ligjore nga Neni 27 par.1 i LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Dokumentit përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata Komerciale po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, për arsye se me dispozitën e nenit 21 të Ligjit të Procedurës Përmbarimorë përcaktohet se *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në rastin konkret në bazë të dokumentit përmbarimor Vendimin i kreditorit i përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga neni 27 par.1 të LPP-së, pasi që në vendimin përmbarimor është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe kur e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr. 08/2023 i dt.15.02.2023 të lejuar nga përmbaruesi privat.

Në rastin konkret edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, pasi që akti administrativ përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe përmbarueshmërisë, i cili vendim është nxjerr konform autorizimeve ligjore të organit të administratës. Prandaj edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij konform nenit 69 par.5 te LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP, prandaj vendosi qe këto pretendime ti refuzoj si te pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.602/24, me datë 13.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova